

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**

“SIDEK AlbEnergy” sh.p.k

Tiranë më datë 9/12/2019

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “SIDEK AlbEnergy” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

**NENI 2**

**Emri i Shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“SIDEK AlbEnergy” sh.p.k**

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë.

Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
2. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
3. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
4. Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import-eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
5. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;
6. Prodhimi i energjisë nga hidrocentralet
7. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;
8. Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;
9. Mirëmbajtja e centraleve energjitike;

10. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.
11. Shitja e energjisë

#### NENI 4

##### Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Kati 6-të, Tiranë, Shqipëri.

#### NENI 5

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 3.700.000 lekë. Kapitali ndahet në dy (2) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Shoqëria “CEDIS” S.R.L, me NUIS 01314290857, përfaqësuar nga administratori i saj z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.850.000 ALL.
2. z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.850.000 ALL.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

#### NENI 6

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### NENI 7

##### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat k fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit për të themeluesit dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

#### **NENI 13**


#### **Dispozitat përfundimtare**

**“SIDEC ALBENERGY” SH.P.K**


Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU**


**ADMINISTRATORI**

  
**“CEDIS” S.R.L.**  
**CEDIS S.r.l.**  
Via G. Cascino, 425 - 93012 Gela (CL)  
Partita IVA 01314290857  
Amministratore Unico  
(Geom. Di Dio Andrea)

Andrea di DIO



Andrea di DIO





Elona SYLA  
Notere



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
Notere Elona A. SYLA

Nr. 2868 / Rep  
2

### V È R T E T I M

Ne Tirane, sot, me date 09/12/2019 (Dymije e nentembëdhjetë) para meje Noteres Elona A. Syla, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën “Rr. Shyqyri Bërxolli”, Pall. “Aurora”, Kt.2, Tiranë, u paraqit personalisht:

1. **Andrea di Dio**, i datelindjes 28.01.1976, lindur ne Gela, Itali, shtetas Italian, madhor me zotesi te plote dhe per te vepruar, i identifikuar me pashaporten me nr. YB4126960, ne cilesine e administratorit te Shoqerise “CEDIS” S.R.L
2. **Andrea di Dio**, i datelindjes 28.01.1976, lindur ne Gela, Itali, shtetas Italian, madhor me zotesi te plote dhe per te vepruar, i identifikuar me pashaporten me nr. YB4126960.

Te cilet në cilësinë e ortakeve themelues të Shoqerise “SIDEC AlbEnergy” shpk konfirmuan nënshkrimin e tyre ne Aktin e Themelimit te dates 09.12.2019 te kesaj shoqerie, per krijmin e saj me vullnetin e tyre te lire e te pavesuar, dhe une noteri pasi u binda për identitetin e tij nëpërmjet dokumentit individual qe mbante me vete e vërtetoj atë sipas kompetencave që parashikon neni 128 i ligjit 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.



STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE

“SIDEC AlbEnergy” sh.p.k

Tiranë, më 09/12/2019

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare “SIDEC AlbEnergy” sh.p.k rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe dispozitat e tjera të lëgjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

Ortakët e shoqërisë janë:

1. Shoqëria “CEDIS” S.R.L, me NIPT 01314290857 përfaqësuar nga administratori i saj z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.850.000 ALL.
2. z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.850.000 ALL.

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik, që prej datës në të cilën është kryer regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 1

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë.

Konkretisht:

1. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
2. Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
3. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
4. Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import-eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;

5. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;
6. Prodhimi i energjisë nga hidrocentralet
7. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;
8. Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;
9. Mirëmbajtja e centraleve energjitike;
10. Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.
11. Shitja e energjisë

## NENI 2

### Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimi me emërtimin e saj “SIDEC AlbEnergy” sh.p.k.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Kati 6, Tiranë, Shqipëri.

## NENI 3

### Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin ose zgjatjen e afatit të veprimtarisë së shoqërisë, sipas një vendimi të posaçëm.

## NENI 4

### Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k). veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

## NENI 5

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të saj. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve Themelues.

## NENI 6

### Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t’u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objekti të veprimtarisë së saj përcaktuar në nenin 1.

## NENI 7

### Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) Abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) Trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) Në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

## NENI 8



### Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendur më sipër mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asamabelja e përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  të votave.

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo të statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) Të përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) Të kërkojë ndërprejen e veprimtarisë konkurruese;
- c) Të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritje së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

- a) Të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen në llogari të shoqërisë;
- b) T'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) T'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë

### NENI 9

#### Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratori duhet të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortaku do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njej si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqrisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

#### NENI 10

##### **Përjashtimi i ortakut**

Në bazë të një vendimi të zakonshem, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nësi ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime t tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- Me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqrisë ose ortakëve të tjerë;
- Me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara në ligj;
- Përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- Me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjshtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të dret'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

### **III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË**

#### NENI 11

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut.

Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

#### NENI 12

Kapitali fillestar i investuar nga Ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasi të shumave të derdhura në fazën e themelimit.

#### NENI 13

## “SIDEC ALBENERGY” SH.P.K

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 3.700.000 lekë. Kapitali ndahet në dy (2) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Shoqëria “CEDIS” S.R.L, me NIPT 01314290857, përfaqësuar nga administratori i saj z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.850.000 ALL.
2. z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.850.000 ALL.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

### NENI 14

#### Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- Shit-blerjes;
- Trashëgimisë;
- Dhurimit;
- Në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

### NENI 15

#### Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

### NENI 16

Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhen me anulimin e tyre.

Rastet e anulimit të kuotës do të përcaktohen nga rregullore të posaçme, të miratuara nga Asambleja e Ortakëve me 51 % të votave. Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij statuti.

### NENI 17

### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk dhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërt Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

### **NENI 18**

#### **Fondet rezervë**

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.

Ajo disponon lirisht mjetet financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

### **NENI 19**

#### **Përdorimi i të ardhurave neto**

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

### **NENI 20**

#### **Bilanci, plani financiar**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhën të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve sipas miratimit të Ortakëve të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose në valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

### **NENI 21**

#### **Shpërndarja e fitimeve**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

## NENI 22

### Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve

Shoqëria mund t’u shpërndajë ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kerkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori, i cili nga pakujdesia përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

## IV. ORGANET E SHOQËRISË

### NENI 23

#### Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  e votave në rastet e mëposhtme:

1. Ndryshimet e statutit;
2. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. Shpërndarjen e fitimeve;
5. Raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

Për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

1. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
3. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
4. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
5. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

6. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
7. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga ambasadorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
9. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

#### NENI 24

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtëme:

- Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak një pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

#### NENI 25

##### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftim me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetën nëse të gjithë ortakët e saj janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### NENI 26

##### Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortekët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për

çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo jete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

## NENI 27

### Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Në rast se shoqëria ka faqe interneti, Administratori duhet të publikojë një kopje të procesverbalit në faqen e internetit të shoqërisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e Mbledhjes.

## NENI 28

### Hetimet e posaçme

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 % për qind të totalit të votave në asamblesë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe-ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e

përgjithshme nuk merr nja vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kerkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Në rastet e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë t’i kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit apo statutit. Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund t’i kërkojë Asamblesë sërat përpara gjykatës ndiqen nga një përfaqësues i posaçëm i shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të për përfaqësimin e tij në interes të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

## V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 29

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është z. Andrea di Dio, lindur më 28/01/1976 në Gela, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. YB4126960, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat k fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 30

#### Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga sambleja e përgjithshme;
2. Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;



5. Krijohë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit
7. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
8. Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut
9. Të njoftojë Asamblenë e Përgjithshme në lidhje me implementimin e politikave tregtare dhe për realizimin e transaksioneve që kanë rëndësi të veçantë për ecurinë e shoqërisë
10. Të thërrasë asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim
11. Në rast se Asambleja e Përgjithshme cakton më shumë se një Administraor, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga sambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe
12. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
13. Administratori ka të drejtë të lidhë marrëveshje huaje ose kredi, vetëm me miratimin e asamblesë së ortakëve, me shumicë absolute.

## NENI 31

### Shpërblimi i administratorëve

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t’i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme, shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

**NENI 32**

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregulohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

**NENI 33**

Të punësuarit dhe punojësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

**VI. PRISHJA E SHOQRISË. LIKUJDIMI**

**NENI 34**

Kjo Shoqëri do të prishet në rast kur:

1. Merr vendim Asambleja e Përgjithshme;
2. Hapen procedurat e falimentimit;
3. Nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;
4. Merret një vendim gjykate;
5. Për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrë Kombëtare të biznesit nga Administratori.

**NENI 35**

**Likuidimi i shoqërisë**

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjshim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sias vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratori i shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Biznesit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas dispozitave ligjore përkatëse.

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë nga ndiqet shënimi “në likuidim”. Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

### NENI 36

#### Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen të pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

### NENI 37

#### Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyra financiare vjetore të shoqërisë. Bilance miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### NENI 38

#### Shpërndarja e aktiveve

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

**NENI 39**

**Likuidimi i thjeshtëzuar**

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

Administratorët, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare Të Biznesit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.

Administratori është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

**VII. DISPOZITAT E FUNDIT**

**NENI 40**

Ky statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 41**


Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhur me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 42**


Ky Statut është hartuar në Tiranë (Shqipëri) në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKU**

**ADMINISTRATORI**

  
CEDIS S.r.l.  
Via C. Gaspari, 425, 93012 Gela (CL)  
Partita IVA: 01317290857  
Amministratore Unico  
(Geom. Di Dio Andrea)

  
Andrea di DIO

  
Andrea di DIO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
Notere Elona A. SYLA

Nr. 2867/Rep  
12

V È R T E T I M

Ne Tirane, sot, me date 09/12/2019 (*Dymije e nentembëdhjetë*) para meje Noteres Elona A. Syla, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën “Rr. Shyqyri Bërxolli”, Pall. “Aurora”, Kt.2, Tiranë, u paraqit personalisht:

1. **Andrea di Dio**, i datelindjes 28.01.1976, lindur ne Gela,Itali, shtetas Italian, madhor me zotesi te plote dhe per te vepruar, i identifikuar me pashaporten me nr. YB4126960, ne cilesine e administratorit te Shoqerise “CEDIS” S.R.L
2. **Andrea di Dio**, i datelindjes 28.01.1976, lindur ne Gela,Itali, shtetas Italian, madhor me zotesi te plote dhe per te vepruar, i identifikuar me pashaporten me nr. YB4126960.

Te cilet në cilësinë e ortakeve themelues të Shoqerise “SIDEC AlbEnergy” shpk konfirmuan nënshkrimin e tyre ne Statutin te dates 09.12.2019 te kesaj shoqerie, per krijimin e saj me vullnetin e tyre te lire e te pavesuar, dhe une noteri pasi u binda për identitetin e tij nëpërmjet dokumentit individual qe mbante me vete e vërtetoj atë sipas kompetencave që parashikon neni 128 i ligjit 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.

